



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO  
**KOMUNA E GJAKOVËS**  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore duke u bazuar në nenin 67, 68 dhe 69 paragrafi 2 të Ligjit numër 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 5 paragrafi c të Ligjit numër 03/L-068 mbi Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës, Udhëzimin Administrativ (MASHTI) numër 05/2021 dhe 01/2022 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Udhëzimin Administrativ (MASHT) numër 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional, si dhe nenin 2 paragrafi 2 të Statutit të Komunës së Gjakovës, shpall:

**KONKURS PËR PRANIM**

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar

<b>Emri i grupit:</b>	Specialistë të Arsimit
<b>Institucioni:</b>	Komuna e Gjakovës
<b>Njësia:</b>	Drejtoria për Arsim
<b>Lloji i pozitave:</b>	Nëpunës i Shërbimit Publik
<b>Data e njoftimit:</b>	18.01.2023
<b>Afati për aplikim:</b>	18.02.2023 – 03.03.2023
<b>Numri i referencës:</b>	01-111/01-1234

**1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës:**

- a. Të realizoj plan programin mësimor për vendin e punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që të rregullojë fushat përkatëse për vendin e punës;
- b. Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- c. Të përgatit me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë;
- d. Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe vlerësimit në përputhje me Udhëzimet Kurikulare;
- e. Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- f. Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës, si dhe
- g. Detyrat tjera që janë të përcaktuara me legjislacionin në fuqi.

**2. Kërkesat e përgjithshme për pranim:**

- a. Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- b. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c. Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- d. Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- e. Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- f. Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

### 3. Kërkesat e përgjithshme formale:

Sipas Udhëzimit Administrativ (MASHTI) numër 05/2021 dhe 01/2022 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) numër 05/2015 Normativi për Mësimdhënësit e Arsimit Profesional.

Në mungesë të kandidatëve të kualifikuar për pikën 2 të tabelës, mund të vijnë në shprehje edhe kandidatët e profileve të përfaqëta.

### 4. Pozitat aktualisht të lira:

Nr.	Titulli i pozitës	Statusi	Vendi i punës
1.	Tre (3) mësimdhënës mbështetës	Vend i lirë	Në shkollat e Komunës së Gjakovës, varësisht nga nevoja.
2.	Gjashtë (6) asistent për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta	Vend i lirë	Në shkollat e Komunës së Gjakovës, varësisht nga nevoja.
3.	Një (1) mësimdhënës për lëndët juridike me 16 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHMLE “Kadri Kusari”
	Një (1) mësimdhënës për lëndët ekonomike me 20 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	
	Një (1) mësimdhënës për lëndët ekonomike me 20 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjeografisë me 6 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	
4.	Një (1) mësimdhënës për lëndën instruktor ( <i>module praktike</i> ) i elektros me 20 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHMLT “Nexhmedin Nixha”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e elektroteknikës me 20 orë mësimi në javë.	Vend i lirë 08.06.2023	
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e transportit rrugor me 20 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	
5.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës frënge me 6 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHML Gjinnazi "Hajdar Dushi"
6.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e kitarës me 10 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	Shkolla e Muzikës "Prek Jakova"
	Një (1) mësimdhënës për lëndën kontrabas me 10 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e violinës me 10 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	
7.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e biologjisë me 20 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Selman Riza”

	Një (1) mësimdhënës për lëndën e biologjisë me 16 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Dëshmorët e Kombit” dhe SHFMU “Ukshin Miftari”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e biologjisë me 8 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Pjetër Muqaj”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e biologjisë me 18 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHFMU “Zef Lush Marku” dhe SHFMU “Zekeria Rexha”
8.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e kimisë me 18 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Dëshmorët e Kombit”, SHFMU “Pjetër Muqaj” dhe SHFMU “Ukshin Miftari”
9.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me 12 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Hamëz Cena”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me 16 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Kongresi i Manastirit”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me 20 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHFMU “Hamëz Cena”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me 12 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHFMU “Zef Lush Marku”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me 18 orë mësimi në javë	Zëvendësim	SHFMU “Shaban Golaj”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e matematikës me 16 orë mësimi në javë	Zëvendësim	SHFMU “Zekeria Rexha”
10.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e TIK-ut me 8 orë mësimi në javë.	Vend i lirë	SHFMU “Kongresi i Manastirit”
11.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e gjuhës gjermane me 7 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHMU "Mazllum Këpuska"
12.	Një (1) mësimdhënës për lëndën art figurativ me 11 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHMU “Mazllum Këpuska”, SHFMU “Jahë Salihu”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën art figurativ me 10 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHFMU “Zekeria Rexha”
13.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e historisë me 8 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHFMU “Engjëll Gjoni”
	Një (1) mësimdhënës për lëndën e edukatës qytetare me 4 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	
14.	Një (1) mësimdhënës për lëndën e edukatës fizike me 20 orë mësimi në javë.	Zëvendësim	SHFMU “Emin Duraku”

## 5. Mënyra e aplikimit:

Aplikacionet merren në *Qendrën e Informimit*, kati përdhese në ndërtesën e Komunës së Gjakovës si dhe mund të shkarkohet nga ueb faja e Komunës së Gjakovës, dhe i plotësuar dorëzohet

personalisht në Zyrën e Pranimit apo të dërgohen me postë në këtë adresë: Komuna e Gjakovës, Rruga "UÇK" numër 53, 50000 Gjakovë, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kati III.

## **6. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim:**

- a. Formulari i aplikimit, i plotësuar;
- b. Rezymeja personale (CV);
- c. Kopjet e dokumentit personal (*letërnjoftim ose pasaportë*);
- d. Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore të noterizuara (*personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë diplomat e nostrifikuara nga Ministria e Arsimit*);
- e. Kopjet e dëshmisë së punësimit;
- f. Kopjet e dëshmisë së trajnimeve;
- g. Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (*lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më i vjetër se 6 muaj*);

## **7. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve:**

- a. Testimi me shkrim
- b. Intervistë

## **8. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët dhe shpallja e rezultateve përfundimtare:**

Përmes ueb faqes së Komunës së Gjakovës (<https://kk.rks-gov.net/gjakove/>) dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>).

## **9. Sqarime shtesë:**

- a. Dokumentet duhet të jenë në kopje sepse ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.
- b. Informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- c. Komunitetet jo shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional, siç specifikohet në Ligjin për Zyrtarët Publikë.
- d. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë dhe aplikacionet e mangëta nuk pranohen.